



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA PUKË
KESHILLI BASHKIAK



Nr. 157/2 prot:

Puke, me 12.02.2026

VENDIM

Nr 02 datë 11.02.2026

“PER MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DUKE PËRDORUR DERI NË 6%,TË FONDIT TË NDIHMËS EKONOMIKE PER VITIN 2026”

Mbeshtetur ne ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”(i ndryshuar), neni 54, germa k, bazuar ne nenin 21 te ligjit nr.9355,date 10.03.2005”Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore “(ndryshuar),bazuar ne VKM nr.955 date 07.12.2016”Per percaktimin e kriterëve ,Dokumentacionit dhe Mases se Ndihtes Ekonomike”si dhe bazuar ne Udhezimin Nr,5 date 17.02.2017, ”Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmen ekonomike deri në 6%”, me propozim te kryetarit te Bashkise , Keshilli bashkiak pasi e shqyrtoi:

VENDOSI

1. Të miratojë Kriteret Specifike për vitin 2026 mbi të cilat do te bazohet Vendimi i Keshillit Bashkiak për të trajtuar me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok- ndihmen ekonomike, për familjet, të cilat nuk shpallen fitues sipas formulës se pikëzimit, si më poshtë:

1. Familje te varfra pa te ardhura apo me te ardhura te pamjaftueshme, qe nuk plotesojne nevojat baze per jetese.
2. Familje qe kane ne perberje nje ose me shume anetare me aftesi te kufizuar/invalid pune.
3. Familje me shume femije
4. Familje me k/familjare femra pa te ardhura apo me te ardhura te pamjaftueshme.
5. Familje me k/familjare femra me te ardhura te pamjaftueshme, dhe probleme sociale.
6. Persona qe jetojne te vetem ,te moshuar apo dhe te rinj me problem social ekonomike.
7. Familje me te ardhura te pamjaftueshme qe ka ne perberje femije qe ndjekin arsimin e larte.
8. Familjet qe nuk kane banese ose jetojne me qera.
9. Familje qe kane ne perberje te moshuar, qe nuk kane pension ose e kane pension minimal.

10. Kryefamiljare te veja apo te divorcuara pa te ardhura apo me te ardhura te pamjaftueshme.

II -Dokumentat e aplikuesve janë sipas VKM nr.955 date 07.12.2016”Për percaktimin e kriterëve ,Dokumentacionit dhe Mases se Ndhmes Ekonomike”.

III -Masa e ndihmes ekonomike llogaritet siopas VKM nr.955 date 07.12.2016”Per percaktimin e kriterëve ,Dokumentacionit dhe Mases se Ndhmes Ekonomike”.dhe Udhezimit nr 4 date 17.02.2017”Per perllogaritjen e perfitimit te ndihmes ekonomike”

IV. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Ndhmës Ekonomike.

V. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”

VI. Vendimi u shpall me date 12 .02.2026

Vota te vlefshme gjithsej : 9

Vota pro 9 vota kunder 0, vota abstenim 0

SEKRETARI

Hazbi Terbuni



KRYETARI

Gjon GJOKA



Lënda: Mbi Vendimin Nr. 2, datë 11.02.2026 të Këshillit të Bashkisë Pukë.

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit Nr.21, datë 5.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhëri i MB Nr. 39, datë 20.02.2025 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” Aneksi I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 24, neni 54, shkronja “n”, neni 55, pika 2, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar, shqyrtoi **Vendimin Nr. 2, datë 11.02.2026** të Këshillit të Bashkisë Pukë “Për miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar 6% për ndihmën ekonomike”.

Pas trajtimit, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI
Holta DUDA

